# FORCA JONË

* * * Viti VI • Nr. 58 • Qershor 2017 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës * * *


## Ministri i FSK-së Haki Demolli u prit nga ministri i Mbrojtjes së Turqisë Fikri Isik



Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK), zotëri Haki Demolli, (12 maj 2017) zhvilloi një takim në Stamboll me ministrin e Mbrojtjes të Republikës së Turqisë, zotëri Fikri Isik, gjatë qëndrimit të tij në panairin e 13-të Ndërkombëtar të Mbrojtjes (IDEF 2017), në Turqi. Në takimin e përbashkët, ministri Demolli dhe ministri i Mbrojtjes të Turqisë, zotëri Isik, folën për marrëdhëniet e mira ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Turqisë si dhe për bashkëpunimin dhe koordinimin e shkëlqyeshëm ndërmjet FSK-së dhe Ushtrisë së Turqisë në përgjithësi. Ministri Demolli e falënderoi në veçanti ministrin Isik, për mbështetjen e vazhdueshme që Ministria turke e Mbrojtjes po jep për FSK-në, si në fushën e arsimimit; me anë të programeve të ndryshme për shkollimin dhe trajnimin e kuadrove ushtarake dhe civile, ashtu edhe në mbështetjen me donacione dhe ofrimin e shërbimeve mjekësore për trajtimin e pjesëtarëve të FSK-së, në Qendrën Spitalore të Ushtrisë së Republikës së Turqisë. Nga ana e tij, ministri i Mbrojtjes të Republikës së Turqisë, zotëri Fikri Isik shprehu gatishmërinë e Turqisë për ta vazhduar bashkëpunimin e plotë dhe të përkushtuar për Kosovën, me theks të veçantë për zhvillimin dhe avancimin e FSK-së si institucion për të cilin populli i Kosovës ka investuar shumë. Në takim, Ministri shoqërohej nga këshilltari ushtarak i tij, kolonel Fadil Hadergjonaj si dhe atasheu i FSK-së në Ankara, nënkolonel Bekim Osmani.

## Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama priti në takim anëtarin e Kongresit amerikan z. Steve King



Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës(FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama priti në takim, në Ministrinë e FSK-së, anëtarin e Kongresit të SHBA-ve, republikanin nga Ajova, zotëri Steve King. Në takimin e përbashkët të gjeneral Ramës dhe kongresistit King u bisedua për marrëdhëniet e mira ndërmjet SHBA-ve dhe Kosovës, bashkëpunimin e mirë ndërshtetëror në mes të Kosovës dhe Ajovës dhe në veçanti për bashkëpunimin dhe koordinimin e aktiviteteve ndërmjet FSK-së dhe Gardës Kombëtare të Ajovës dhe Ushtrisë amerikane në përgjithësi. Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, e njoftoi kongresistin King për zhvillimin dhe avancimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës si dhe për progresin e saj në aspektin e nderveprueshmerisë me të gjithë partnerët, sipas standardeve të NATO-s. Gjithashtu, gjeneral Rama e njoftoi anëtarin e Kongresit Steve King edhe mbi planet strategjike për zhvillimin e Forcës së Kosovës, konkretisht mbi synimin e shtetit të Kosovës që FSK-ja të transformohet në Forcë të Armatosur, me mision dhe detyra të mbrojtjes së vendit. Gjeneral Rama e siguroi kongresistin King se FSK-ja i ka bërë të gjitha përgatitjet, është plotësisht e gatshme për transformim, dhe pret vendimmarrjen politike të institucioneve më të larta të shtetit. Gjithashtu, gjeneral Rama ritheksoi qe i gjithë procesi i transformimi do të jetë transparent dhe në koordinim me partnerët strategjikë të Republikës së Kosovës. Nga ana e tij, kongresisti amerikan Steve King shprehu gatishmërinë e SHBA-ve për ta vazhduar bashkëpunimin e plotë dhe të përkushtuar për Kosovën, me theks të veçantë për zhvillimin dhe avancimin e FSK-së, si institucion për të cilin populli i Kosovës ka investuar shumë. Gjithashtu, kongresisti King shprehu përkushtimin për të lobuar për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet Ajovës dhe Kosovës në të gjitha fushat me interes të përbashkët.

## Kapiteni i FSK-së shpallet oficeri më i mirë ndërkombëtar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës



Oficeri i Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK-së), kapiten Mentor Ibrahimi, pjesëtar i Batalionit të Dytë të Brigadës për Reagim të Shpejtë të FSK-së, u shpall oficeri më i mirë ndërkombëtar në kursin "Kapiten Karriere" në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Mentor Ibrahimi që nga shtatori i vitit 2016 e deri më 18 maj 2017, ka marrë pjesë në kursin "Kapiten Karriere" në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Gjenerata 17-1, dhe prej të gjithë oficerëve pjesëmarrës, nga shtete të ndryshme, u shpall më i miri. Kapiteni Mentor Ibrahimi gjatë shkollimit të tij, në Kursin e Karrierës për Kapiten të Këmbësorisë në Qendrën e Ekselencës (Maneuver Center of Excellence) në Fort Benning të SHBA-ve, ka shfaqur performancë të jashtëzakonshme në fushat, si: Procesi i Vendimmarrjes Ushtarake, Terminologjia dhe Grafika Ushtarake dhe në Doktrinën Amerikane në përgjithësi. Ndërkaq, pas përfundimit të kursit "Kapiten Karriere", kapiteni Mentor Ibrahimi shpallet studenti më i mirë ndërkombëtar, me ç 'rast nga komandanti i kursit gjeneral major Eric Wesley, si shenjë mirënjohjeje për arritje të jashtëzakonshme, i dhurohet libri me përmbajtje ushtarake "Fjalë për luftëtarët".

## Tetari i FSK-së, Binak Podrimçaku shpallet ushtari më i mirë në Garën Ndërkombëtare në Kroaci



Në Garën Ushtarake Ndërkombëtare, që u zhvillua në Knin të Kroacisë, nga data 18-19 maj 2017, pjesëtari i Forcës së Sigurisë të Kosovës, tetari Binak Podrimçaku u shpallë ushtari më i mirë i garës. FSK-në në Garën Ushtarake Ndërkombëtare e përfaqësuan dy pjesëtarë, tetarët: Binak Podrimçaku dhe Liridon Selimi. Gara ushtarake e zhvilluar në Kroaci është njëra ndër garat më të forta në botë, e ku morën pjesë mbi 150 pjesëmarrës nga vendet e NATO-s dhe vendet partnere për zgjedhjen e ushtarit më të mirë ndërkombëtar. Garuesit në ditën e parë u testuan në gjuajtje me armë të ndryshme, dhe në ditën kryesore; marshuan 35 kilometra me ngarkesë 15.2 kg dhe ekzekutuan 12 detyra ushtarake. Në renditjen e përgjithshme të Garës Ushtarake Ndërkombëtare për vitin 2017, Kosova zuri vendin e parë, vendin e dytë e zuri Austria, ndërsa vendin e tretë Shqipëria. Ky është suksesi i radhës i FSK-së, që po dëshmon profesionalizmin dhe standardet e larta të ushtarëve të FSK-së.

## Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama priti zyrtarin e lartë të NATO-s z. Michel Soula

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama ka pritur sot, (11 maj 2017) në një takim zyrtar një delegacion të NATO-s, të kryesuar nga z. Michel Soula, udhëheqës i Sektorit për Operacione në Komitetin Ndërkombëtar të NATO-s, i cili shoqërohej nga gjeneral brigade Dietmar Mosmann, drejtor i NALT-it (Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s), oficerë dhe zyrtarë të lartë të NALT-it. Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, duke e falënderuar delegacionin e NATO-s për vizitën, i ka njoftuar ata gjerësisht me zhvillimet e përgjithshme në FSK. Me këtë rast, ai u fokusua te procesi dhe procedurat e deritashme të përgatitjeve për transformimin e



FSK-së, duke vlerësuar se Ministria dhe FSK kanë kryer bazën ligjore dhe fazat e planifikimit të detajuar për përfundimin me sukses të këtij procesi. Po ashtu komandanti i FSK-së e njoftoi mysafirin e lartë nga Brukseli me mbajtjen e suksesshme të konferencës "FSK dhe Partnerët", ku janë trajtuar arritjet e deritashme në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe fushat ku duhet thelluar ky bashkëpunim me partnerët, në bazë të nevojave që ka FSK-ja. Në takim ai foli edhe për publikimin e Strategjisë për Integrimin e Komuniteteve Pakicë, e cila është bërë në prani të partnerëve ndërkombëtarë, shoqërisë civile dhe mediave. Në vazhdim të fjalës së tij, ai tha se kjo strategji nuk ka ngelë vetëm projekt, por janë bërë edhe aktivitete konkrete për realizimin e saj për çka ne si FSK dhe ministri jemi të kënaqur me rezultatet e arritura. Ndërsa në fjalën e tij Sekretari i Përgjithshëm, z. Shkëlzen Sylaj, ndër të tjera e njoftoi mysafirin për projektin për realizimin e planit të integritetit, që është duke u bërë në bashkëpunim me shtetin e Norvegjisë, duke theksuar se ky është i pari plan i integritetit që po bëhet në institucionet shtetërore të Kosovës, duke shpresuar që do jetë model edhe për ministrit tjera. Nga ana e tij z. Michel Soula u shpreh i kënaqur me aktivitet e deritashme të ndërmarra nga ministria dhe FSK, si për përgatitjet që janë bërë për transformimin e FSK-së në FAK, dhe për qasjen e hapur dhe bashkëpunuese që ka pasur ndaj kësaj çështje. Ai po ashtu vlerësoi lartë edhe angazhimet konkrete për inkuadrimin e komuniteteve pakicë në FSK, duke u angazhuar se komunikimi dhe bashkëpunimi në mes NATO-s dhe FSK-së do të jetë i vazhdueshëm për të gjitha çështjet. Në takim ishte i pranishëm edhe Faruk Geci, drejtor i Drejtorisë Politike të MFSK-së.

## Ministri Haki Demolli dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama në Panairin Ndërkombëtar të Mbrojtjes në Stamboll

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, Haki Demolli së bashku me komandantin e FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, sekretarin e Përgjithshëm të MFSK-së, z. Shkëlzen Sylaj dhe një delegacion i lartë i FSK-së, nga data; 09-12 maj 2017, morën pjesë në "Panairin e 13-të Ndërkombëtar të Mbrojtjes IDEF 2017" në Stamboll të Turqisë. Gjatë vizitës, delegacioni i FSK-së, ka zhvilluar takime të rëndësishme dypalëshe me pjesëmarrës të panairit nga ministritë e mbrojtjes të shteteve të ndryshme. Po ashtu takime të nivelit të lartë janë mbajtur edhe me zyrtarë dhe oficerë të lartë të ushtrisë së Turqisë. Në këto takime temë e bisedimeve ka qenë rritja dhe thellimi i bashkëpunimit edhe në të ardhmen në fushat me interes të përbashkët. Gjatë qëndrimit në panairin ndërkombëtar, delegacioni i FSK-së, ka vizituar prodhimet e ekspozuara të shumë kompanive ndërkombëtare, që po marrin pjesë në këtë panair, me pajisjet dhe teknikën e tyre ushtarake. Pjesë e delegacionit të MFSK/FSK-së, ishin edhe drejtori i Operativës dhe Trajnimeve gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, këshilltari ushtarak i ministrit kolonel Fadil Hadergjonaj, atasheu ushtarak i FSK-së, në Ankara, nënkolonel Bekim Osmani, kapiten Jaser Mulla, Florin Hoxha, sekretar i sekretarit të Përgjithshëm dhe Latif Leka, shef i kabinetit të Ministrit të MFSK-së.



## Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe SP z. Shkëlzen Sylaj pritën ambasadorin e Kanadasë



Sot, (24 maj 2017) në ambientet e Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama së bashku me sekretarin e përgjithshëm të MFSK-së, z. Shkëlzen Sylaj, priten në takim ambasadorin e Kanadasë, për Kroaci dhe Kosovë, z. Daniel Maksymiuk. Në këtë takim, KOMFSK dhe Sekretari i Përgjithshëm e njoftuan ambasadorin me të arriturat e përgjithshme të MFSK/FSK-së si dhe me proceset dhe rrugën për të ardhmen e FSK-së. Ambasadori i Kanadasë, z. Maksymiuk edhe njëherë konfirmoi gatishmërinë e shtetit të tij, për përkrahje të pa rezervë për MFSK/FSK-në dhe shtetin e Kosovës në përgjithësi. Me këtë rast, ambasadori i Kanadasë shprehu gatishmërinë dhe kërkoi inicimin e nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit me MFSK/FSK-në, për zhvillimin e aktiviteteve konkrete në fushën e trajnimit dhe avancimit të pjesëtarëve të FSK-së. Ndërsa, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, gjithashtu konfirmoi që edhe MFSK/FSK-ja, janë të gatshëm për nënshkrim të një marrëveshje të tillë e cila hapë rrugë të reja për ngritjen profesionale te të gjithë pjesëtarëve të MFSK/FSK-së.

## Sekretari i MFSK-së, z. Shkëlzen Sylaj mori pjesë në takimin e CIDS-it në Vjenë të Austrisë

Sekretari i përgjithshëm i MFSK-së, Shkëlzen Sylaj së bashku me asistentin e tij personal, z. Florin Hoxha me ftesë të CIDS (Center for Integrity in Defence Sector / Qendra për Integritet në Sektorin e Mbrojtjes) nga data 25 deri më 27 maj 2017, qëndruan në Vjenë të Austrisë, për të marrë pjesë në takimin e përbashkët me përfaqësues të CIDS-it dhe ekspertë rajonalë të CIDS- it. Në këtë takim z. Damir Ahmetovic-ekspert rajonal i CIDS-it dhe z. Florian Qehaja- udhëheqës i ekipit të CIDS për Kosovë, në prani të Knut Walbækken/ CIDS Oslo dhe Svein Eriksen/ CIDS Senior Advisor, prezantuan raportin e implementimit të projekteve për periudhën trevjeçare: Menaxhimi i Resurseve Njerëzore dhe Ngritja e Integritetit në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK). Gjatë takimit sekretari i përgjithshëm i MFSK-së, z.Sylaj falënderoi Qeverinë norvegjeze për përkrahjen e vazhdueshme që i ofron MFSK-së, në veçanti me dy projektet shumë të rëndësishme për MFSK-në. Me këtë rast, sekretari i përgjithshëm shfrytëzoi rastin që me qëllim të thellimit të bashkëpunimit të kërkojë nga përfaqësues të CIDS-it, që gjatë periudhës së ardhshme të nënshkruajë Marrëveshje Bashkëpunimi me MM të Norvegjisë. Po ashtu në këtë takim sekretari i përgjithshëm para përfaqësuesve të CIDS, shfrytëzoi rastin që të paraqesë propozimet e tij dhe arsyetimin për vazhdimin e përkrahjes edhe për periudhën e ardhshme trevjeçare.



FORCA JONË

Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria për Forcën e Sigurisë të Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma "Adem Jashari", Prishtinë
Adresa elektorinike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel:038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

## Në Ministrinë për FSK u hap zyra e përhershme për Bashkëpunim të Mbrojtjes e Ambasadës Amerikane

Që nga sot, (5 maj 2017) në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), do të jetë e hapur zyra e përhershme e Zyrës për Bashkëpunim të Mbrojtjes (Office for Defense Cooperation - ODC), e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e cila do të funksionoj, tani e tutje, në baza ditore. Në ceremoninë e hapjes së zyrës së ODC-së, në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, ishin të pranishëm: ministri i FSK-së, Haki Demolli, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, sekretari i përgjithshëm, Shkëlzen Sylaj, atasheu i Mbrojtjes të SHBA-vë, kolonel Jefry Fisher, oficerët e lartë të FSK-së: gjeneral brigade Zymer Halimi, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, përfaqësues të Zyrës për Bashkëpunim të Mbrojtjes të SHBA-ve, oficerë të Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s për MFSK/FSK-në, si dhe oficerë e zyrtarë të MFSK-së dhe FSK-së. Hapjen zyrtare të Zyrës së ODC-së në MFSK e bëri ministri Haki Demolli i cili e vlerësoi këtë akt, si moment mjaft të rëndësishëm, sepse tani e tutje praktikisht, bashkëpunimin e suksesshëm të do ta realizojmë duke qenë më afër dhe në kontakt në baza ditore. Më tutje, Ministri Demolli, në emrin e tij, të Komandantit të FSK-së dhe gjithë stafit të Ministrisë dhe Forcës u shpreh, se personeli i Zyrës për Bashkëpunim të Mbrojtjes të SHBA-ve, do të kenë përkrahjen dhe mbështetjen e gjithanshme gjatë shërbimit të tyre në ambientet tona. Nga ana e tij, shefi i ODC-SHBA, major Brian Devlin tha se kjo zyrë do të kontribuojë edhe më shumë në thellimin e bashkëpunimit në mes të MFSK/FSK dhe Ushtrisë së SHBA-ve. Zyra për Bashkëpunim në fushën e Mbrojtjes është strukturë përgjegjëse për bashkëpunim bilateral në fushën e mbrojtjes në mes të Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe strukturave ushtarake të Departamentit të Mbrojtjes së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Komandën Evropiane të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të përfaqësuar nga shefi i Zyrës për Bashkëpunim në fushën e Mbrojtjes (US-ODC).



## Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës prezantoi Strategjinë për integrimin e komuniteteve

Sot (4 maj 2017) në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK) u bë prezantimi dhe diskutimi i Strategjisë për integrimin e pjesëtarëve të komuniteteve në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Referenca për hartimin e Strategjisë ishin: Deklarata e Ministrit të FSK-së për Politikën e Komuniteteve Etnike e datës 12.10. 2016, si dhe vendimi i Sekretarit të Përgjithshëm të MFSK-së (grupi punues) për hartimin e Strategjisë për integrimin e komuniteteve etnike në MFSK/FSK(07.11.2016).Në këtë takim morën pjesë, ministri Haki Demolli, zv.ministri Muhamet Latifi, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, sekretari i përgjithshëm, Shkëlzen Sylaj, gjeneralët: Zymer Halimi dhe Nazmi Brahimaj, ambasadorë dhe përfaqësues të ambasadave, pjesëtarë të Ekipit Këshillues të NATO-s për MFSK/FSK, përfaqësues të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së etj. Fillimisht, ministri Haki Demolli ri-konfirmoi vlerësimin dhe



gatishmërinë e tij dhe të MFSK-së lidhur me punën e palodhshme që është bërë në planin e integrimit të pjesëtarëve të komuniteteve në FSK. Ai tha: se draftimi, aprovimi dhe implementimi i Strategjisë për integrimin e komuniteteve jo-shumicë tregon përkushtimin e vazhdueshëm të Qeverisë së Kosovës dhe të MFSK-së, si dhe është dëshmi se FSK-ja është e hapur për të gjithë qytetarët, pa marrë parasysh prejardhjen etnike, racore, religjioze apo të kaluarën politike. Në fund, ministri Demolli tha se qëllimi final i MFSK-së është rritja e numrit të pjesëtarëve nga komunitetet jo-shumicë deri në 10 për, me perspektivë në strukturë dhe rangje, si dhe u zotua se: "FSK-ja do të jetë e pranishme me aktivitete edhe më tutje në vendbanimet me komunitetet jo-shumicë, sidomos në ato lokalitete ku komuniteti serb jeton më në shumicë". Ai pos tjerash, tha se FSK-ja ka punuar shumë në drejtim të aplikimit të planifikimeve për integrimin e suksesshëm të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë, për të shërbyer për vendin, në kuadër të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Ndërsa, prezantimin e dokumentit strategjikë për integrimin e pjesëtarëve të komuniteteve në FSK, në emër të grupit punues e bëri shefja e zyrës së Komuniteteve në MFSK, znj. Azemina Çullum e cila tha se vizioni i Ministrisë për FSK është që të krijojmë dhe të mbajmë një forcë shumë etnike me perspektive të fortë dhe të qëndrueshme.

Kurse komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, tha:"Ne me veprimin tonë, jemi vërtet model. Fillimisht kemi bërë shumë për me ndërtua besimin, sidomos te komuniteti serb, duke u shprehur i bindur se strategjia për integrimin e komuniteteve do të jetë program, ndërsa gatishmëria për ta zbatuar dhe angazhimi konkret do të jenë detyrë e vazhdueshme e MFSK-së dhe FSK-së.,,FSK ka bërë përpjekje në mënyrë të vazhdueshme për të inkurajuar pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve jo shumicë në Kosovë dhe rekrutimin e tyre në FSK. Pjesëmarrja dhe përfshirja e komunitetit jo shumicë ka qenë sfiduese dhe njëra ndër proceset më të vështira në kuadër të integrimit të tyre në FSK deri më tani, por përkushtimi ynë konkret mbetet, që komunitetet jo-shumicë t'i integrojmë dhe ky integrim të jetë i vazhdueshëm dhe i qëndrueshëm, duke shprehur përkushtimin se mbi bazën e kritereve dhe standardeve që vlejnë për të gjithë, FSK-ja synon që 10 për qindëshin do ta tejkalojë, gjithmonë duke respektuar standardet e rekrutimit", përfundoi fjalën e tij, komandanti i FSK-së, gjeneral Rama.

Ndërsa, atasheu i Mbrojtjes pranë ambasadës së SHBA-ve, koloneli Jefry Fisher tha se: "Këtë çka ka bërë FSK-ja, është shembull i mirë edhe për të tjerët". Ai tha se: ,,hapi i ardhshëm sfidues është realizimi i këtij plani dhe unë kam besim në udhëheqjen e mirë të drejtuesve të FSK-së."Strategjia për integrim të komuniteteve jo shumicë përcakton qëllimet dhe politikat që do të zbatohen, përmes integrimit të të gjitha aktiviteteve dhe proceseve, për të siguruar realizimin e objektivave dhe qëndrueshmërinë e integrimit të komuniteteve jo shumicë.

## Komandanti i KDS-së, gjenerali Enver Cikaqi vizitë zyrtare në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë

Komandanti i Doktrinës dhe Stërvitjes të Forcës së Sigurisë të Kosovës gjeneral brigade Enver Cikaqi, me ftesë të komandantit të KDS-së të FA të Republikës së Shqipërisë, gjeneral brigade Manushaqe Shehu, qëndroi për vizitë tri ditore në Republikën e Shqipërisë, me q 'rast mori pjesë edhe në ceremoninë e përfundimit të Kursit të Lartë të Oficerit. Delegacioni i FSK-së, është pritur nga zëvendës ministri i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë, z. Petro Koçi, drejtori i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Tonin Marku, komandanti i Forcave Tokësore gjeneral brigade Nazmi Cahani dhe komandanti i KDS-FARSH, gjeneral brigade Manushaqe Shehu. Gjatë takimeve, delegacioni i FSK-së, është njoftuar me operacionet dhe stërvitjet që FARSH janë duke zhvilluar brenda dhe jashtë vendit, si dhe me procesin e modernizimit me armatime dhe pajisje tjera brenda forcës. Gjithashtu u bisedua edhe për bashkëpunimin e deritanishëm të dy institucioneve, si dhe për thellimin e këtij bashkëpunimi në të ardhmen. Bazuar në përvojën që ka krijuar ushtria shqiptare, por edhe inkuadrimi i saj në strukturat euro-atlantike, është diskutuar



gjatë për mënyrat e bartjes së dokumenteve doktrinarë dhe adaptimit të tyre në forcën tonë. Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë kanë mbështetur bibliotekën e KDS-FSK-së me dokumente doktrinarë dhe tituj librash të ndryshëm, dokumente dhe libra të cilat do të shërbejnë si bazë e mirë për përpilimin apo rishikimin e dokumenteve aktuale. Komandanti i KDS-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi dhe delegacioni i FSK-së, gjatë qëndrimit në Shqipëri vizituan edhe oficerët e lartë të FSK-së, të cilët janë duke ndjekur trajnime në shkollat ushtarake të FARSH. Vizita të ndërsjella ka pas edhe në të kaluarën nga komandantët e të dy Komandave si dhe do të ketë edhe në ardhmen me qëllim të thellimit të bashkëpunimit dhe koordinimit të veprimeve, si dhe të njohjes dhe shkëmbimit të përvojave në mes të dy institucioneve (FSK dhe FARSH) u tha gjatë takimeve.

# Në BRSH me sukses u realizua gara sfiduese ‘UJKU GARUES 2017’



Në Brigadën për Reagim të Shpejtë në kazermën "Ushtarët e NATO-s" në Istog, u realizua gara "Ujku Garues 2017". Kjo garë është realizuar për herë të tretë në nivel të BRSH-së, ku garuesit sfidohen në shkathtësi profesionale dhe fizike. Në garë morën pjesë gjithsejtë 13 ekipe, secili batalion i BRSH-së me nga 3 ekipe, gjithsej 9 ekipe, BMO me tri ekipe dhe KDS-ja me një ekip. Disiplinat në te cilat u sfiduan garuesit ishin këto: Vrapimi 3.2 km, hedhja e granatës së dorës, shtyrja e autoblindës, vëzhgim, kalimi i zonave të minuara dhe kalimi mbi zona të rrezikshme. Synimi kryesor i organizimit të kësaj gare ka qenë që ekipet pjesëmarrëse të sfidoheshin në disiplinat e lartcekura, në mënyrë që të dëshmonin përgatitjen fizike dhe mendore. E gjithashtu, kjo garë është realizuar me qëllim të motivimit të pjesëtarëve për ngritjen e vazhdueshme të shkathtësive profesionale dhe bashkëpunimit të ndërsjellë ndërmjet njësive të FSK-së. Ceremonia e certifikimit të garës së shkathtësive ushtarake "Ujku Garues 2017" u realizua sot (29 maj 2017) në kazermën "Ushtarët e NATO-s" në Istog. Në ceremoni ishin të pranishëm: Gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, KOMBRSH kolonel Xhevahir Geci, zv. KOMBMO kolonel AvdiRaci, rreshter majorja komanduese e Gardës së IOWA-s Reachel Fails, Shtabi i BRSH-së, komandantet e batalioneve, oficerë dhe nënoficerë të BRSH-së dhe njësive tjera të FSK-së. KOMBRSH, kolonel Geci gjatë fjalës së tij drejtuar të pranishmëve shfrytëzoi rastin t'i uronte të gjitha ekipet për sukseset që treguan në këtë garë. Ai veç tjerash tha: "Qëllimi i ynë është që përmes kësaj gare të ngremë nivelin e punës ekipore, shpirtin garues dhe përgatitjen fizike dhe profesionale të pjesëtarëve të njësive tona. Kjo garë ka arritur që jo vetëm të jetë sfiduese, por gjithashtu ka karakter miqësor duke e ngritur edhe më shumë bashkëpunimin ndërmjet njësive të FSK-së, më qëllim që të gjithë së bashku të arrijmë synimet tona madhore. Garat dhe aktivitetet që po zhvillohen brenda FSK-së janë duke ndikuar dukshëm në sukseset dhe rezultatet që në vazhdimësi po tregojnë pjesëtarët e FSK-së në trajnime, në shkolla prestigjioze ushtarake dhe në gara të ndryshme jashtë vendit. Ekipet garuese të FSK-së treguan përkushtim dhe disiplinë maksimale, duke bërë që kjo garë të bëhet edhe më sfiduese dhe të arrijë objektivin për të cilin është dizajnuar. Angazhimi i përbashkët i pjesëtarëve në ekipet e tyre dëshmoi për rëndësinë që ka individi në ekip si dhe rëndësinë që ka puna ekipore në arritjen e suksesit të përbashkët. Gjithashtu është për t'u vlerësuar dhe angazhimi i Shtabit të Brigadës, rreshterit të parë dhe ekipit të instruktorëve, të cilët me sukses arritën të menaxhojnë organizimin dhe realizimin e kësaj gare. Planifikimi dhe organizimi profesional, vlerësimi transparent dhe rritja e interesimit për pjesëmarrje janë shenjat më të mira që gara "Ujku Garues" është duke evoluar dhe zhvilluar edhe më tej".Në fund të garës, në bazë të performancës së treguar, në mënyrë transparente u bë përzgjedhja e tri vendeve të para të cilat u vlerësuan me çmime si në vijim: Vendi i tretë-BRSH-Batalioni i Tretë-K3A, vendi i dytë-BRSH-Batalioni i Parë, Ekipi i Tretë dhe vendi i Parë-BRSH-Batalioni i Dytë K2B. Nga komandanti i BRSH-së, tri vendet e para u shpërblyen me Emblemën e BRSH-së, të gjitha ekipet pjesëmarrëse me certifikata, ndërsa rreshter majorja amerikane Reachel Fails u nderua me mirënjohje.







## FSK-ja vëzhguese në ushtrimin e përbashkët të kërkim-shpëtimit "Anatolian Star" në Izmir të Turqisë



Nga data 02 deri më 04 maj 2017, në regjionin detar dhe malor të Izmirit të Turqisë u mbajt ushtrimi i forcave të përbashkëta të kërkim-shpëtimit "Anatolian Star". Përveç forcave ekzekutuese të ushtrimit nga ushtria turke, morën pjesë edhe delegacionet e 12 shteteve në mesin e të cilave edhe delegacioni i FSK-së, në përbërje: shefi i Sektorit për Plane, Programe dhe Analiza në MFSK, nënkolonel Sefer Isufi, atasheu ushtarak në Turqi, nënkolonel Bekim Osmani dhe atasheu policor në Turqi, z. Blerim Dajaku. Faza e parë e ushtrimit u zhvillua në ujërat ndërkombëtare dhe në hapësirën ajrore të Detit Egje, dhe u realizua nga ana e trupave të Rojës Bregdetare të Forcave Turke, sipas skenarit të planifikuar dhe të koordinuar përmes sistemit satelitor për kërkim-shpëtimin e ekuipazhit të anijes së përfshirë nga zjarri para përmbytjes. Faza e dytë e ushtrimit u mbajt në lokacionin Menemen të qarkut të Izmirit, sipas skenarit për kërkim-shpëtimin e alpinistëve të humbur. Oficerët tanë në këtë ushtrim ishin në cilësinë e vëzhgueseve, krahas oficerëve të shteteve tjera pjesëmarrëse, performanca e të cilëve u vlerësua lart nga ana e nikoqirit, komandantit të operacionit, shefit të Shtabit të Armatës së Egjeut, gjeneral Özgür Nuhut. Duke pasur parasysh se FSK-ja njësitë e saj të kërkim-shpëtimit i ka në nivel të lartë profesional, në takimin e realizuar me nikoqirin u diskutua edhe mundësia e pjesëmarrjes së një togu të kërkim-shpëtimit të FSK-së në ushtrimin e ardhshëm. Në fund të ushtrimit, nënkolonel Sefer Isufi në emër të komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, gjeneralit Nuhut i dorëzoi stemën e FSK-së, në shenjë falënderimi dhe mirënjohjeje për ftesën dhe mbështetjen që forcat turke treguan në avancimin e kapaciteteve dhe aftësive operacionale të Njësisë së Kërkim-Shpëtimit të FSK-së. Ky ushtrim gëzoi vëmendje maksimale jo vetëm të mediave turke por edhe të atyre ndërkombëtare, për shkak të zhvillimeve në Zonën e Mesdheut e posaçërisht të operacioneve sistematike për shpëtimin e emigrantëve ilegalë të zhvendosur nga zonat e luftës të cilët me varka ia mësynin brigjeve evropiane.

## Institucionet dhe Agjencitë e Kosovës për menaxhimin e krizave realizuan ushtrim të përbashkët





Në kazermën "Evropianët e Rinj" në Pomozotin, u mbajt sot ushtrimi fushor i institucioneve dhe agjencive të Kosovës për menaxhimin e krizave në raste të incidenteve me tren. Në këtë ushtrim ishin të përfshira njësitet e këtyre institucioneve dhe agjencive: Ambasada Amerikane, KFOR-i Amerikan, Forca e Sigurisë së Kosovës, Agjencia për Menaxhim të Krizave, Policia e Kosovës, Hekurudhat e Kosovës, Zjarrfikësit, tri brigada ( Prishtinës, Drenasit dhe Llapnasellës), Kryqi i Kuq i Kosovës, dega në Fushë Kosovë dhe Stafi nga Qendra kryesore e Mjekësisë Familjare në Fushë Kosovë. Për ta përcjellë nga afër këtë ushtrim ishin të pranishëm edhe: zv. komandanti i Komandës së Forcave Tokësore gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, zv. komandanti i Brigadës së Mbështetjes Operacionale (BMO) kolonel Avdi Raci, komandanti i Regjimentit të Mbrojtjes Civile (RMC) kolonel Shaip Haziri, udhëheqësi i ekipit për mbështetje nga Ambasada Amerikane kapiten Peter Preisinger, zv. kryeshefi i Trainkos-it Naim Neziri, drejtori i Departamentit të Operimeve në Trainkos, drejtori i Departamentit të Gatishmërisë në Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave Hajriz Sejdiu, drejtori i Departamentit të Parandalimit në Agjencinë e Emergjencave Alush Beqiri etj. Me këtë rast gjeneral brigade Gëzim Hazrolli përshëndeti dhe përgëzoi institucionet e përfshira në këtë ushtrim për bashkëpunimin e shkëlqyer gjatë këtij ushtrimi. "Jemi shumë të kënaqur me planifikimet dhe realizimet e shumta që i kemi zhvilluar viteve të fundit. Edhe ushtrimi i sotëm ishte me rëndësi të veçantë për ne, sepse nxjerr mësimet e mësuara në ngritjen e kapaciteteve dhe bashkëpunimin në menaxhimin e krizave në të ardhmen, me të vetmin qëllim që të shpëtojmë jetë njerëzish në Kosovë",- tha nder të tjera gjeneral Hazrolli.

## Certifikohen 30 pjesëtarë të FSK-së, në seminarin "Koha e rreshterit për trajnim"

Në kazermën "Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore (KFT), gjegjësisht në Batalionin e Xhenios, u mbajt ceremonia e certifikimit të 30 pjesëtarëve të cilët përfunduan trajnimin një javor "Koha e rreshterit për trajnim".Në këtë ceremoni të pranishëm ishin: Gjeneral brigade Zymer Halimi, drejtor i Drejtorisë për Operacione në MFSK, kolonel Naim Haziri, shef i Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore si dhe oficerë e nënoficerë të FSK-së dhe KFOR-it. Fillimisht të pranishmëve ju drejtua gjeneral Halimi, drejtor i Drejtorisë për Operacione në MFSK, i cili pasi përshëndeti dhe falënderoi instruktorët e Gardës Kombëtare të IOWA-s, për kontributin e vazhdueshëm që janë duke e dhënë në zhvillimin e korit të nënoficerëve të FSK-së, si dhe shtetet që po ndihmojnë FSK-në, ndër tjera, tha: "Sukseset e juaj gjatë këtij seminari, dhe sukseset e FSK-së në përgjithësi, po na bëjnë të ndihemi krenar me ju. Këto arritje individuale dhe kolektive janë tregues më i mirë që FSK-ja po arrin suksese të shkëlqyeshme si brenda dhe jashtë vendit, së bashku me partnerët tanë dhe sidomos me Gardën Kombëtare të Ajovës".Më tej, gjeneral Halimi, tha se: "Qëllimi i mbajtjes së këtij seminari është shkëmbimi i përvojave lidhur me kanalin mbështetës të nënoficerëve, dhe jam shumë i kënaqur me arritjet që janë bërë deri më tani në këtë fushë, ku fokusi i këtij seminari ka qenë tek "Koha e Rreshterit", të cilën ne jemi duke e aplikuar në njësitë tona dhe po tregojmë rezultate pozitive në ngritjen e performancës në njësi. Më vjen mirë që pjesëmarrës në këtë seminar kanë qenë edhe oficerët; kjo ju ndihmon atyre të kuptojnë edhe më mirë rolin e nënoficerit në njësi por edhe t'i identifikojnë fushat ku ata duhet t'ju japin më tepër mbështetje nënoficerëve. Ne kemi punuar në konceptin për zhvillimin e NOF për një periudhë 3-5 vjeçare, mirëpo ne duhet të vazhdojmë t'i identifikojmë nevojat për zhvillimin sa më të mirë të nënoficerëve dhe t'i inkorporojmë ato në këtë koncept".Gjeneral Halimi më pastaj nga pjesëtarët e FSK-së, të sapo certifikuar, kërkoi që të gjitha njohurit e fituara nga ky seminar t'i bartin me sukses te njësitet e tyre, me qëllim që me këto njohuri të pajisen edhe kolegët tjerë, nëpër njësi. Ndërsa, rreshter majori i parë i FSK-së, Genc Metaj dhe rreshter majorja e Komandës së Gardës së Ajovës, Rachel Fails, folën për mbajtjen dhe rendësin e seminarit, duke theksuar se të gjithë pjesëmarrësit gjatë seminarit treguan interesim dhe gatishmëri për të pajisur me njohuri të reja. Në fund, gjeneral brigade Zymer Halimi u ndau certifikatat instruktorëve të Gardës Kombëtare të AJOVËS.



# Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama ndau mirënjohje për kompanitë private që ndihmuan profesionalizmin e FSK-së

Komandanti Forcës së Sigurisë të Kosovës(FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, ndau sot (23 maj 2017) Mirënjohje disa kompanive vendore nga fusha e mekanikës, në pritjen që ai rezervoi për përfaqësuesit e këtyre kompanive, të cilat kanë mbështetur ngritjen dhe avancimin e kapaciteteve profesionale të mekanikës së FSK-së. Me këtë rast, gjenerallejtënant Rrahman Rama priti koordinatorin e Projektit të Partneritetit për Arsim Profesional në Kosovë, z. Franc Musolli, pastaj z. Faik Salihun nga Shkolla e Mesme Profesionale ,,Shtjefën Gjeçovi"në Prishtinë, z.Feriz Hoxha, përfaqësues i ,,AHP"në Prizren, z. Haki Abdullahu, përfaqësues i ,,BAKI"në Llapnasellë, z. Skënder Kaqandolli, përfaqësues i kompanisë ,,Kaqandolli"në Prishtinë, si dhe përfaqësuesin e Odes Ekonomike të Kosovës dhe nënkolonelin gjerman Michael Gierse, këshilltar në Departamentin e Logjistikës së FSK-së. Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama fillimisht i falënderoi përfaqësuesit e kompanive vendore dhe ata të Odes Ekonomike të Kosovës dhe Odes Zejtare të Dortmundit-Gjermani, për bashkëpunimin si dhe ofrimin e përkrahjes dhe mbështetjes në profesionalizimin e pjesëtarëve të FSK-së, në mirëmbajtje të automjeteve të FSK-së. Gjithashtu, gjeneral Rama tha se; "Forca e Sigurisë së Kosovës është në proces të vazhdueshëm të ngritjes dhe avancimit të kapaciteteve profesionale në të gjitha fushat, e me theks të veçantë është e përkushtuar që të profesionalizojë kuadro për mekanikë dhe mirëmbajtje të automjeteve, që tani dhe në të ardhmen të përkujdeset me kapacitetet e veta për makinerinë që posedon dhe këtë mirëmbajtje ta bëj sipas standardeve të NATO-s në mënyrë që kudo që vepron dhe kudo ku angazhohet të jetë e ndërvepruseshme". Ndërsa, nga ana e tyre të gjithë afaristët u shprehën të gatshëm, që edhe në të ardhmen ta përkrahin Forcën e Sigurisë së Kosovës në avancimin e kapaciteteve profesionale dhe çmuan lartë angazhimin e pjesëtarëve të FSK-së, gjatë kryerjes së kurseve të mekanikës. Në fund, komandanti i FSK-së, gjeneral Rama ndau mirënjohje për Odën



Ekonomike të Kosovës dhe Odën Zejtare të Dortmundit, si dhe për përfaqësuesit e kompanive, me motivacion: ,,Për kontributin e jashtëzakonshëm në ngritjen dhe zhvillimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, me rastin e mundësimit të trajnimit profesional në fushën e automekanikes për mirëmbajtjen e mjeteve të motorizuara sipas standardeve gjermane të aftësimit profesional".

# Kadetët e Kosovës në shënimin e Ditës së Personelit Ushtarak në Akademinë e Forcave të Armatosura të Turqisë

Më datën 21.05.2017 në Akademinë Ushtarake të Forcave të Armatosura Turke në Ankara, është shënuar Dita e Personelit Ushtarak Mysafir (MAP Günü). Në këtë ditë, i gjithë personeli i huaj kishte për detyrë që të përfaqësojë vendin e vet me ushqime, veshje kombëtare, uniformën ushtarake, fotografi me bukuritë natyrore, broshura të ndryshme rreth organizimit dhe aktiviteteve ushtarake etj. Në mesin e 297 kadetëve nga 18 shtete të ndryshme të botës, Republikën e Kosovës e prezantuan edhe 12 kadetët e Kosovës që studiojnë në Akademinë Ushtarake në Turqi, ndërsa të pranishëm ishin edhe kadetët që janë duke vijuar mësimet në Fakultetin e Mjekësisë Ushtarake (GATA). Nën organizimin e atasheut ushtarak të FSK-së në Ankara, nënkolonel Bekim Osmani, ata prezantuan shkëlqyeshëm




Republikën e Kosovës, FSK-në, ushqimet dhe veshjen tradicionale të vendit tonë. Ky lloj manifestimi është tradicional dhe organizohet çdo vit. Tani që kemi edhe atasheun tonë në Turqi, për dallim nga vitet e kaluara, mbështetja për kadetët nga ana e FSK-së, ishte më e madhe dhe çdo gjë shkoi shumë më mirë, falë përkujdesjes së atasheut ushtarak. Përveç komandantit të Akademisë që ishte nikoqir, për ta përcjellë këtë ngjarje kishin ardhur edhe shumë gjeneralë dhe oficerë tjerë të lartë vendorë si dhe atashe nga vende të ndryshme të botës. Gjatë vizitës së tyre tek këndi i Kosovës, nga atasheu ynë ata u njoftuan me atë që kishin përgatitur për përfaqësim duke ua përshkruar në pika të shkurtra historinë dhe bukuritë natyrore të Kosovës. Pas kësaj aktivitetet vazhduan tek këndi i ushqimeve tradicionale, ku të pranishmit patën rastin që të shijojnë ushqime të ndryshme tradicionale nga të gjitha vendet pjesëmarrëse në Akademinë Ushtarake. Kadetët tanë, në mënyrë të shkëlqyer kishin përgatitur këndin e përfaqësimit dhe këndin e ushqimeve të cilat nuk kaluan pa fjalë miradije nga komandanti i Akademisë Ushtarake dhe të gjithë të pranishmit tjerë. Në fund, atasheu ynë u kujdes që disa mysafirëve të veçantë t'u ndajë nga një dhuratë simbolike me motive nga Republika e Kosovës. Edhe këtë vit, kjo paraqitje u realizua me përkrahjen e FSK-së, Ambasadës së Republikës së Kosovës në Ankara dhe familjeve të stafit të ambasadës.

# Certifikohen kadetët në Kursin e Avancuar për Lider në KDS

Në mjediset e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS), u mbajt sot ceremonia e certifikimit të kadetëve të Kursit të Avancuar për Lider. Të pranishëm në këtë ceremoni ishin: gjeneral brigade Enver Cikaqi-komandant i KDS, Kolonel Irfete Spahiu- zëvendëskomandant i KDS, Kolonel Predrag OMRCEN këshilltar i ekipit ndërlidhës të NATO-s (NALT) për FSK, si dhe oficerë të FSK dhe NALT-it. Komandanti i KDS-s, gjeneral brigade Enver Cikaqi, mbajti një fjalë rasti duke ju dëshiruar mirëseardhje të pranishmëve dhe suksese kadetëve të certifikuar në këtë ceremoni. Gjeneral Cikaqi vuri theksin te roli dhe rëndësia e trajnimeve për ushtarakët e FSK-së, pa marrë parasysh nivelin dhe njësinë. Ai ndër të tjera tha: " Të gjithë pjesëtarët e FSK-së duhet të jenë të përgatitur për detyra dhe organizime të reja. Përgatitjen tuaj e kam vërejtur edhe gjatë trajnimeve. Ju posedoni veti të mira në menaxhim, udhëheqje dhe disiplinë. Këto janë vetëm disa nga vetitë që duhet t'i posedojë ushtaraku. Dua të ju përgëzoj edhe për angazhimin tuaj gjatë këtij kursi. Njohuritë të cilat i keni fituara këtu nëse i mbani për vete nuk kanë ndonjë efekt, andaj ju këshilloj që këto njohuri t'i shpërndani tek kolegët nëpër njësitë tuaja".Ndërsa, në emër të Qendrës për Zhvillim Profesional të Udhëheqësve foli Zv. KOMQZHPU major Skender Haliti, i cili tha: " Kursi i Avancuar për Lider është një kurs sa sfidues po aq edhe tërheqës. Mund të them se kadetët e kësaj gjenerate kanë treguar rezultate të larta, falë angazhimit të instruktorëve dhe interesimit të tyre. Sot nuk kemi nevojë të flasim ne, flasin rezultatet të cilat kadetët i kanë arritur gjatë kësaj periudhe 7 javore, ku ata janë ballafaquar me sfida të ndryshme, sidomos në terren, por motivimi dhe përkushtimi i tyre ka bërë që detyrat t'i realizojnë me sukses".Disa nga temat e këtij kursi ishin: Lidershipi, navigimi tokësor, taktikat luftarake, menaxhimi i trajnimit, ushtrimet fushore, fitnesi fizik etj. Vlen të theksohet se Kursi i Avancuar për Lider është gjenerata e parë për vitin 2017, i cili është përgatitur nga instruktorët e ushtrisë amerikane dhe është përshtatur me nevojat e FSK-së.



# Në kazermën e BRSH-së, u realizua ceremonia e certifikimit të trajnimit "Taktikat me njësi të Vogla", Gjenerata 01/2017

Në kazermën "Ushtarët e NATO-s"të Brigadës për Reagim të Shpejtë të FSK-së, në Istog, u mbajt sot (5 maj 2017) ceremonia e certifikimit të 47 pjesëtarëve të cilët përfunduan trajnimin ,,Taktikat me Njësi të Vogla".Në këtë ceremoni të pranishëm ishin: Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës gjenerallejtënant Rrahman Rama, ushtruesi i detyrës së komandantit të BRSH-së, kolonel Xhevahir GECI, zëvendëskomandanti i Brigadës së Mbështetjes Operacionale kolonel Avdi RACI, shefi i Shtabit të BRSH-së nënkolonel Ejup Maqedonci, këshilltari i KOMFSK-së, kolonel Lindsay si dhe oficerë e nënoficerë të Shtabit të BRSH-së. Fillimisht të pranishmëve ju drejtua ushtruesi i detyrës së komandantit të BRSH-së, kolonel Xhevahir GECI, i cili ndër tjera tha: "Pjesëtarët e BRSH-së si në nivelin individual ashtu edhe në atë kolektiv janë duke vazhduar edhe këtë vit të përfaqësojnë në mënyrën më të mirë veten e tyre, institucionin dhe shtetin tonë. Këtë e dëshmojnë rezultatet e larta që ata po arrijnë si në gara ashtu edhe në shkollime dhe trajnime brenda dhe jashtë vendit. Një ndër trajnimet më të veçanta që planifikon, organizon dhe realizon BRSH-ja është trajnimi "Taktikat me Njësi të Vogla".E veçanta e këtij trajnimi këtë vit ka qenë përfshirja e pjesëtareve femra, të cilat përkundër sfidave dhe programit intensiv kanë arritur që me përkushtim dhe vullnet të jashtëzakonshëm të përfundojnë këtë trajnim në mënyrën më të mirë. Ai, me ketë rast, i përgëzoj pjesëtaret e këtij trajnimi për angazhimin dhe vullnetin që treguan dhe kërkoi nga ta që t'i mirëmbajnë shkathtësitë e fituara dhe njohuritë t'i shpërndajnë në njësitë e tyre. Po ashtu të pranishmëve ju drejtua edhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, "Ne, si FSK po arrijmë suksese të mëdha, gjë që dëshmon se jemi forcë profesionale dhe e përgatitur mirë. Por nuk duhet të kënaqemi me kaq, duhet të vazhdojmë punën në realizimin e objektivave tona që të jemi pjesë e Aleancës Veri Atlantike-NATO-s".Për mbarëvajtjen e trajnimit foli edhe përgjegjësja e këtij trajnimi, toger Manushaqe Nura, e cila nder të tjera u shpreh; "Pjesëtarët u sfiduan në shumë disiplina, por ata treguan performancë dhe lidership gjatë kësaj periudhe 4 javore, ku shumica e trajnimit u realizua në terren".Ndërsa, këshilltari britanik i KOMFSK kolonel Lindsay, i uroi pjesëmarrësit për përfundimin me sukses të trajnimit, "E di që ka qenë trajnim sfidues dhe i vështirë, sepse është i njëjti që kryhet edhe në SHBA apo Britani të Madhe, andaj ju përgëzoj për ketë, tani do të jeni më të përgatitur në të gjitha sfidat që mund të përballeni. Trajnimi ,,Taktikat për Njësi të Vogla" ka filluar më 11 prill 2017 dhe ka zgjatur deri më 05 maj 2017.Në kuadër të pjesëmarrësve në trajnim,përveçpjesëtarëve të tri batalioneve të BRSH-së,kanë marrë pjesë edhe katër pjesëtarë nga BMO-ja dhe dy pjesëtarë nga KDS-ja. Kjo ka qenë gjenerata e parë për vitin2017, kurse e 13-ta më radhë, e cila është planifikuar dhe realizuar nga Brigada për Reagim të Shpejtë.



Gjatë këtij trajnimi pjesëtarët janë pajisur me njohuri në fusha të ndryshme si në teori ashtu edhe në praktikë, ndërsa fokus kryesor i trajnimit ka qenë ngritja dhe profesionalizimi i pjesëtarëve të BRSH-së dhe njësive tjera të FSK-së për kryerjen e detyrave taktike për realizimin sa më mirë të misionit të tanishëm dhe atë të ardhshëm. Temat e trajtuara gjatë trajnimit janë: Aftësimi i pjesëtarëve në udhëheqje dhe operim me ekipe dhe skuadra, Patrullat, Rikonicion, Repilim, Navigim Tokësor i kombinuar ditën dhe natën, Prita, Reagimi në Kontakt, Qitja taktike dhe stresuese me armë, operacione urbane dhe tema tjera që janë po ashtu të një rëndësie të veçantë për FSK-në në përgjithësi. Sfidat që janë përballur pjesëmarrësit në ketë trajnim kanë ndërtuar pjesëtarë profesionalë të cilët pa marrë parasysh kushtet dhe rrethanat janë të gatshëm të operojnë në të gjitha detyrat që u caktohen nga komanda madhore. Për pjesëtarët të cilët kanë përfunduar këtë trajnim u ndanë certifikata, ndërsa për më të dalluarit shpërblime dhe për instruktorët mirënjohje.

# Mbahet kursi "Menaxhimi i mbrojtjes në kontekstin më të gjerë të sigurisë në Kosovë dhe rajon"

Gjatë muajve prill dhe maj (23.04-05.05.2017) është zhvilluar kursi "Menaxhimi i mbrojtjes në kontekstin më të gjerë të sigurisë në Kosovë dhe rajon", i organizuar nga Ambasada e Britanisë së Madhe dhe i realizuar nga Universiteti Cranfield dhe Ministria e Mbrojtjes së Britanisë së Madhe. Kursi është mbajtur në dy pjesë dhe ka zgjatur dy javë; java e parë është realizuar në Prizren, ndërsa java e dytë në Prevallë. Nga MFSK-ja dhe FSK-ja kanë marrë pjesë 14 pjesëtarë, nga institucionet tjera të Kosovës 12 pjesëmarrës (IPK, Doganat, PK, QS, MPJ, QSSK etj.), si dhe 5 pjesëmarrës nga Republika e Shqipërisë dhe 2 pjesëmarrës nga Republika e Maqedonisë. Hapja zyrtare e kursit është bërë nga atasheut ushtarak i Mbretërisë së Bashkuar, nënkolonel Richard Parry. Kursi "Menaxhimi i mbrojtjes në kontekstin më të gjerë të sigurisë në Kosovë dhe Rajon" kishte për qëllim ngritjen e nivelit të njohurive të pjesëmarrësve, në mënyrë që të përmirësohet qeverisja dhe menaxhimi në sektorin e sigurisë, që do të krijonte mundësi për arritjen e objektivave dhe ndërtimin e një vizioni të përbashkët të çështjeve kyçe në lidhje me sigurinë kombëtare, rajonale dhe globale. Programi i kursit ishte hartuar në atë mënyrë që pjesëmarrësit të marrin njohuri dhe të përparojnë në: të kuptuarit e politikave, strategjive dhe hartimin e tyre; ndërlidhjen e koncepteve teorike të qeverisjes; rifreskimin e koncepteve që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit, transparencën dhe llogaridhënien, menaxhimin e shërbimeve të sigurisë. Pra, objektiv i kursit ishte arritja e standardeve më të larta profesionale duke përfshirë edhe mekanizmat që mundësojnë menaxhimin efektiv të ndryshmeve brenda sektorit të sigurisë. Familjarizimi me normat ligjore vendore dhe ndërkombëtare si dhe familjarizimi me kornizat relevante për qeverisjen e sigurisë përbënte një kapitull të veçantë të kursit. Kursi ka përmbushur synimet e përcaktuara, duke u bazuar në nivelin e lartë të ligjëruesve dhe në cilësinë e ligjëratave të cilat ishin mjaft të rëndësishme dhe përmbajtjesore. Gjatë kursit janë zhvilluar rreth 20 ligjërata dhe gjashtë ushtrime që janë ndërthurur edhe me prezantime individuale dhe grupore. Disa nga prezantimet kanë trajtuar temën e transformimit të FSK-së në FAK, me ç' rast janë shqyrtuar përparësitë, pengesat ligjore, mbështetja regjionale dhe ndërkombëtare si dhe gjetja e mundësive për të arritur qëllimin e dëshiruar. Pjesëtarët e MFSK/FSK-së kanë qenë mjaft aktivë dhe kanë kontribuar në rrjedhën e kursit, duke treguar interesim të lartë për t'u pajisur me sa më shumë njohuri. Në ceremoninë e certifikimit-përmbylljes ka marrë pjesë edhe drejtori i Drejtorisë për Operacione, gjeneral brigade Zymer Halimi, i cili njëherë, edhe u ka nda certifikatat pjesëmarrësve. Kurset e tilla, të organizuara nga Ambasada e Britanisë e të mbajtura nga Universiteti Cranfield dhe Ministria e Mbrojtjes së Britanisë së Madhe, janë mjaft të rëndësishme për institucionet e sigurisë, natyrisht edhe për FSK-në.



# FSK-ja mori pjesë në aksionin "Ta pastrojmë Kosovën"

FSK-ja, për të gjashtin vit me radhë, po e përkrahë aksionin vullnetar "Ta pastrojmë Kosovën" me ushtarë, mjete teknike, ekskavatorë dhe kamionë. Bazuar në planin e Veprimit të Departamentit për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak (DBCU) dhe në koordinim të aktiviteteve me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe drejtuesit e Organizatës joqeveritare "Ta pastrojmë Kosovën" dje, u realizua aktiviteti me moton "Ta pastrojmë Kosovën" në Prishtinë dhe komunat tjera të Kosovës. Në kryeqytet, aksioni "Ta pastrojmë Kosovën" filloi në lagjen "Arbëria" në të cilën morën pjesë nxënës të shkollave të mesme, pjesëtarë të FSK-së, qytetarë dhe përfaqësues të shoqatave të ndryshme. Me këtë rast, nënkoloneli i FSK-së, Afrim Veseli, në emër të FSK-së e ka përshëndetur aksionin për pastrimin e ambientit jo vetëm në kryeqytetin e Kosovës, por në tërë Kosovën, duke shtuar se, "ky aksion tani më është bërë tradicional, ku FSK-ja po kontribuon sado pak në pastrimin e ambientit tonë e që është në të mirë të gjithë qytetarëve të Kosovës. FSK-ja, në aksionin ta pastrojmë Kosovën, po merr pjesë në pastrimin edhe të ambienteve të kazermave të FSK-së, si dhe në pastrimin e qyteteve; në Prishtinë, Istog, Ferizaj, Mitrovicë, Gjilan dhe Prizren, me makineri dhe ushtarë ". "FSK-ja gjithmonë është e gatshme tu del në ndihmë të gjithë qytetarëve të Kosovës, dhe t'i përkrahë edhe përmes aksioneve të tilla, që janë në shërbim dhe interes të tyre" tha në fund nënkoloneli Afrim Veseli.



# Orkestra e FSK-së përformon në kazermën 'Sulltan Murat' në Prizren

Forca e Sigurisë së Kosovës së bashku me udhëheqësit e kampit ushtarak turk, në kuadër të bashkëpunimit me partnerët, në kazermën "Sulltan Murat" në Prizren, kanë realizuar një aktivitet kulturor me Orkestrën Frymore të Forcës së Sigurisë të Kosovës për ushtarët dhe oficerët e KFOR-it turk që shërbejnë në Kosovë. Për të përcjellë nga afër performancen ishin të pranishëm drejtori i Drejtorisë për Operacione në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës gjeneral brigade Zymer Halimi, komandanti i Regjimentit të Mbrojtjes Civile kolonel Shaip Haziri, mysafirë të shumtë, si ministri Mahir Jagxhilar, njëherësh kryetar i Partisë Demokratike Turke të Kosovës, si dhe oficerë e ushtarë të



KFOR-it turk me shërbim në Kosovë. Nikoqiri i këtij organizimi, komandanti i kontingjentit turk në Kosovë, kolonel Mustafa Tavazar, gjatë fjalës së tij të mbajtur me këtë rast ndër tjera tha: "Falënderoj të gjithë të pranishmit për pjesëmarrje dhe njëherësh dua të shpreh kënaqësinë time për profesionalizmin e Orkestrës së FSK-së, e cila para pak javësh kishte performuar së bashku me Orkestrën nga Turqia në mjediset e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Ne, po atë ditë bëmë kërkesë tek ZVKOM i Forcave Tokësore gjeneral brigade Gëzim Hazrolli që të organizojmë një koncert këtu, në kazermën tonë, dhe kërkesa jonë u miratua nga ministri i FSK-së z. Haki Demolli, dhe tani jemi këtu që të përcjellim së bashku interpretimin e bukur të kësaj orkestre".Gjatë këtij koncerti, ku u luajtën vepra dhe marshe të shumta si dhe u interpretuan këngë të bukura në gjuhën turke, të gjithë të pranishmit patën mundësi që të argëtohen dhe të shijojnë interpretimin e tyre të mrekullueshëm nga Orkestra Frymore e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Në fund komandanti i kontingjentit turk, në shenjë falënderimi ndau mirënjohje për Orkestrën e FSK-së.

# Pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës certifikohen për "Brezin e Gjelbërt"

Nëntë pjesëtarë të njësive të ndryshe të Forcës së Sigurisë së Kosovës ( FSK ) u certifikuan sot për Brezin e Gjelbërt nga instruktorët e Marinsave Amerikan. Në këtë ceremoni të certifikimit e cila u mbajt në kazermën ,,Adem Jashari" në Prishtinë, të pranishëm ishin Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, zv. komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, kolonel Irfete Spahiu si dhe eprorë të lartë të FSK-së dhe mysafirë nga Ambasada Amerikane. Me këtë rast, të pranishmëve ju drejtua gjeneral Rama i cili e falënderoi ambasadën Amerikanë për përkrahjen e vazhdueshme qe janë duke e bërë për pjesëtarët e FSK-së, dhe shtoi: "falënderoj Ambasadën Amerikane dhe instruktorët e marinsave amerikan për mbështetjen dhe përkrahjen që janë duke i dhënë FSK-së, pa përkrahjen e partnerëve tanë, ne nuk do të ishim këtu ku jemi sot". Gjenerali Rrahman Rama i përgëzoi edhe pjesëtarët e FSK-së për suksesin e treguar gjatë këtij trajnimi " Ju keni treguar gatishmëri, përkushtim dhe vetëbesim gjatë këtij trajnimi dhe shpresoj që këto përvoja që i keni fituar në ,Arte Marciale, t'i përcjellin për njësitë, aty ku shërbeni". I kënaqur nga realizimi i këtij trajnimi u shpreh edhe Komandanti i Detashmentit Marin Security Gard, rreshter i shtabit Morales Wincenti i cili i falënderoj pjesëtarët e FSK-së për bashkëpunim e treguar gjatë këtij trajnimi, dhe shtoi: " dua t'i falënderoj pjesëtarët e FSK-së për mundësinë qe na dhanë të trajnohemi me ju, por edhe për bashkëpunimin dhe përkushtimin që kanë treguar gjatë realizimit të këtij trajnimi". Me këtë ekip i cili u certifikua sot për brezin e gjelbër, do vazhdojmë edhe për brezin e kaftë dhe të zi, duke shpresuar që të organizojmë edhe trajnimin "Trajno Trajnerët" që në të ardhmen instruktorët FSK-së të realizojnë trajnime të tilla për pjesëtarët e saj. Qëllimi i këtij trajnimi i cili u realizua nga dt. 15-26 maj është që krahas ngritjes profesionale ne fushat e tjera, pjesëtarët e FSK te jenë të përgatitur edhe fizikisht në përballimin e çdo lloj sfide, qoftë fizike apo psikike.



## Batalioni i Tretë i BRSH-së me sukses realizoi vrapin kondicional "VRAPI-2017"

Batalioni i Tretë i Reagimit të Shpejtë të FSK-së, sot (5 maj 2017) realizoi vrapimin kondicional 10 km "VRAPI-2017". Ky aktivitet u realizuar në bazë të planit vjetor të trajnimeve dhe të aktiviteteve për vitin 2017 të Batalionit të Tretë. Qëllimi vrapimit kondicional është ngritja e nivelit të përgatitjes fizike të pjesëtarëve të Batalionit në distanca të gjata. Në këtë sfidë kanë marrë pjesë 164 pjesëtarë. Vrapimi është realizuar në zonën e përgjegjësisë së Batalionit të Tretë. Pjesëmarrësit e vrapit e kanë përfunduar me kohë vrapimin dhe pa ndonjë problem, gjë që dëshmon se kanë një përgatitje të lartë fizike dhe janë të gatshëm në përballimin e çfarëdo detyre dhe sfide. Në vrapim ka marrë pjesë edhe stafi komandues i Batalionit dhe të katër kompanive të Batalionit të Tretë.



## FSK-ja me mjetet financiare të aksionit vullnetar "Vrapo me FSK-në" ndihmon familjet në asistencë sociale të Komunës së Mitrovicës

Pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës dje në Komunën e Mitrovicës shpërndanë mjete financiare si dhe pako higjienike dhe ushqimore për disa familje në nevojë të kësaj komune. Të gjitha këto mjete të cilat dje u shpërndanë për 10 familje të Mitrovicës, pritet që në ditët në vijim të shpërndahen dhe për 5 familje të tjera nga komunitetet e kësaj komune, u mblodhën falë aksionit vullnetar" Vrapo me FSK-në-Mitrovica 2017", i cili u organizua gjatë muajit prill nga ushtarët dhe oficerët e FSK-së. Ky aktivitet u realizua falë bashkëpunimit të mirëfilltë të FSK-së me Komunën e Mitrovicës, ku njerëzit kompetent të komunës gjatë tërë kohës i kanë mbështetur pjesëtarët e FSK-së në përzgjedhjen e familjeve me në nevojë për t'i ndihmuar. Gjatë shpërndarjes së këtyre fondeve, përveç oficerëve të FSK-së, i pranishëm ishte edhe drejtori i Drejtorisë për Integrime Evropiane dhe Mirëqenie Sociale, z. Qazim Nimani së bashku me stafin e tij, i cili përgëzoi FSK-në për realizimin e këtij aksioni dhe njëherësh falënderoi pjesëtarët e saj për ndihmën e ofruar, të cilën e vlerësoi si mjaft të nevojshme për qytetarët e kësaj komune. Familjet që përfituan nga ky aksion ishin mjaft të lumtura, për vet faktin se po ndihmoheshin, pikërisht, nga pjesëtarët e FSK-së të cilët gëzojnë respekt të veçantë jo vetëm në komunën e tyre por tek të gjithë qytetarët e Kosovës. Kjo, nuk është hera e parë që pjesëtarët e FSK-së organizojnë një aktivitet të tillë dhe sigurisht se nuk do të jetë as hera e fundit, pasi që oficerët e rinj të FSK-së premtuan që më përkrahjen e vazhdueshme të eprorëve të FSK-së dhe më vullnetin e mirë të tyre, ata do të vazhdojnë t'i përkrahin qytetarët e vendit edhe në të ardhmen.

